



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:052092

Datë: 06.11.2024

Numri i dokumentit: 06409250

Ac.nr.5432/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci - kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Ylber Shurdhiqi - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M. nga fshati Zh., Komuna e P., të cilin me autorizim e përfaqëson P. P., avokat nga P., Rruga “I. L.”, p.n., kundër të paditurës Agjencia Pyjore e Kosovës, me seli në Komunën e Prizrenit, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit H.S. – G., Zyrtare për Çështje Juridike në Drejtoratin Koordinues të paditurës, me objekt të padisë, vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.454/2021 të datës 19.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Agjencia Pyjore e Kosovës, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.454/2021 i datës 19.04.2022, dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: REFUZOHET tërësisht e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A. M., nga fshati Zh., Komuna e P., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi, është pronar i sipërfaqes prej 6955 m², e cila ndodhet në ngastrën kadastrale Nr. ..., . Zh., me masa dhe kufij nga ana veriore 61.56 m, nga ana jugore 59,73, nga ana lindore 141,75 m dhe nga ana perëndimore 113,02 m.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.454/2021 të datës 19.04.2022, ka vendosur si në vijim: “ I. Miratohet kërkesëpadia e paditësit A. M., nga fshati Zh., Komuna e P.. II. Vërtetohet se paditësi A. M.j, nga nga fshati Zh., Komuna e P. është pronar i sipërfaqes prej 6955 m², e cila ndodhet në ngastrën kadastrale Nr. ..., . Zh, me masa dhe kufij nga ana

veriore 61.56 m, nga ana jugore 59,73, nga ana lindore 141,75 m dhe nga ana perëndimore 113,02 m. III. Detyrohet pala e paditur t'ia kompensoj shpenzimet procedural palës paditëse në shumën 980,00€, gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar, dhe të ndryshohet aktgjykimi i atakuar, ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar, ose çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankese nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, ka paraqitur padi, në gjykatën e shkallës së parë me datë 26.04.2010, duke sqaruar se F.M., tani i ndjerë nga fshati Zh., Komuna e P., sipas të dhënave të vitit 1952, ka qenë pronar i ngastrës kadastrale Nr. ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 65.00 ari, që është objekt lëndor. Kjo paluajtshmeri deri në vitin 1979, ka qenë e regjistruar në emër të F.M., mirëpo me matjet e aeroinqizimit i cili është bërë në vitin 1979, e i cili ka hyrë në fuqi me datë 1984, kjo paluajtshmeri pa bazë ligjore është regjistruar si pasuri Shoqërore. Gjatë aeroinqizimit paditësi nuk ka qenë në shtëpi, pasi që i njëjti ka punuar në shtetet e jashtme, ashtu që nuk ka mundur të shenjzën me ngjyrë të bardhë këtë paluajtshmeri, dhe për këtë arsye e njëjta është regjistruar si pasuri shoqërore, si dhe ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Pala e paditur e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke kërkuar nga gjykata e shkallës së parë, që e njëjta të veproj konform dispozitave ligjore të nenit 399 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, si dhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pa bazuar ose ta vazhdoj procedurën sipas dispozitave ligjore lidhur me këtë çështje juridiko civile

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe të te gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.454/2021 të datës 19.04.2022, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, ndër të tjera, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk është kontestuese që sipërfaqja 6955 m², si pjesë përbërëse e njësisë kadastrale..., . Zh, evidentohet si Pasuri Shoqërore. Për palët kontestuese është baza juridike mbi të cilën evidentohet kjo paluajtshmeri. Andaj e paditura ka legjitimitetin pasiv në procedurë, pasi që paluajtshmeria kontestuese evidentohet në emër të sajë. Gjykata e shkallës së parë, vlerëson se ish pronari faktik i asaj paluajtshmerie T.M., prej të cilit paditësi pretendon se e ka blerë paluajtshmerinë nuk mund të jetë palë në procedurë në cilësi të palës së paditur. Pasi që në radhë të parë ai tani është i ndjerë. Në anën tjetër edhe po të ishte gjallë përsëri nuk mund të jetë palë në procedurë pasi që pronar juridik i paluajtshmerisë kontestuese është e paditura. Ashtu që çfarëdo detyrimi që duhet kërkuar nga e paditura, e jo nga ish pronari faktik T. M.. Me rastin e vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit, gjykata ka pasur parasysh që pronësia në bazë të posedimit me mirëbesim nuk mund të fitohet në pronësi shoqërore. Mirëpo të drejtën e pronësisë të cilën e ka fituar e paditura është fituar pa bazë ligjore, në mungesë të një pune juridike dhe vetëm mbi bazën e aëroinqizimit, në bazë të së cilës në librat kadastrale evidentohet në emër të sajë. Librat kadastrale nuk janë libra të tokës, ku është regjistruar e drejta e pronës. Sipas Ligjit mbi Kadastrin, ai është vetëm një regjistër shtetëror në të cilin konstatohet gjendja faktike e tokës përkritazi me pozitën e saj, madhësinë, klasifikimin e kulturës dhe kualitetit. Kësisoj të dhënat kadastrale nuk janë shënime përkritazi me të drejtën e pronës, përkatësisht lidhur me gjendjen juridike të tokës, por vetëm përkritazi me gjendjen faktike, përkatësisht të posedimit. Pala paditëse thirret se këtë paluajtshmeri e ka blerë nga ish pronari. Që nga koha kur e ka blerë, të njëjtën e ka shfrytëzuar pandërprerë dhe i papenguar nga askush deri kur e ka shitur. Faktin që këtë paluajtshmeri pala paditëse e ka blerë nga T. M., gjykata e ka vërtetuar me dëgjimin e dëshmitareve. Gjithashtu edhe faktin se këtë paluajtshmeri pala paditëse e ka në shfrytëzim dhe posedim mbi 20 vite, gjykata e ka vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve. Me asnjë provë të vetme pala e paditur nuk ka mundur të vërteton të kundërtën. Nga gjithë kjo rrjedhë se në praninë e të gjitha provave tjera, vetëm në bazë të shënimeve kadastrale nuk mundë të konstatohet se pjesa e parcela Nr. ..., . Zh në sipërfaqe prej 6955 m², është pasuri shoqërore, pasi që nga të gjitha të dhënat tjera, veçmas nga mendimi i ekspertit është vërtetuar se ajo është pronë private dhe se gabimisht me aëroinqizim është regjistruar si pasuri shoqërore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës

ankuese, mirëpo sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore, për pasojë ka pasur edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet konform nenit 201 pika b) dhe d) të LPK-së, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Si rrjedhojë, Gjykatës se Apelit, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, i rezultoi se nuk është kontestuese që sipërfaqja 6955 m², si pjesë përbërëse e njësisë kadastrale. ..., . Zh, evidentohet si Pasuri Shoqërore. Pala paditëse thirret se këtë paluajtshmeri e ka blerë nga ish pronari, që nga koha kur e ka blerë, të njëjtën e ka shfrytëzuar pandërprerë dhe i papenguar nga askush deri kur e ka shitur. Faktin që këtë paluajtshmeri sipas paditësit, e ka blerë nga T.M., gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar me dëgjimin e dëshmitareve. Gjithashtu edhe faktin se këtë paluajtshmeri pala paditëse e ka në shfrytëzim dhe posedim mbi 20 vite, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve, sipas shkresave të lëndës, me asnjë provë të vetme pala e paditur nuk ka mundur të vërteton të kundërtën. Mirëpo në bazë të provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë edhe pse në aktgjykimin e ankimuar e arsyeton se nuk e mbështet në parashkrim fituese sepse e vlerëson se nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë më parashkrim fitues, në pronë shoqërore, megjithatë nga përmbajta e tërësishme e aktgjykimit të ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e mbështet në parashkrimin fitues në rastin konkret, në Ligjin mbi Pyjet e Kosovës, si dhe duke u mbështetur tek deklaratimet e dëshmitareve. Gjykata e shkallës së parë gabimisht e vlerëson në procedurë të rigjykimit kur e konstaton se paditësi paluajtshmerinë lëndore e ka blerë nga ish pronari faktik i asaj paluajtshmerie T. M., pasi që më asnjë provë shkresore nuk e ka vërtetuar se ndonjëherë paditësi e ka blerë paluajtshmerinë lëndore nga T.M., dhe poashtu nuk është provuar me prova shkresore që gjenden në lëndë se ndonjëherë T. M., tani i ndier ka qenë pronarë i paluajtshmerisë lëndore, prej të cilit paditësi pretendon se ka blerë paluajtshmerinë, andaj nga kjo del se pretendimet paditësit janë të pabazuara. Mëtej kjo gjykatë vlerëson se nga ekspertiza e ekspertës së gjeodezisë T. K., e punuar më datë 25.05.2015 (*të cilës i janë bashkangjitur edhe skica e terrenit dhe janë specifikuar dimensionet, masat, koordinatat dhe kufijtë e kësaj ngastre*), provohet fakti se ngastra kadastrale, e kërkuar me kërkesëpadi nga ana e paditësit, evidentohet

në emër të paditurës, me kulturë arë, kullosë, livadhë, pemishtë, të specifikuara sikurse në këtë ekspertizë. Ky fakt vërtetohet edhe nga Librat kadastrale, ku është regjistruar e drejta e pronës të cilat janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë dhe gjenden në shkresat e lëndës, në të cilat konstatohet se pronare e kësaj ngastre të cekur si më lartë, është e paditura. Nga të gjitha këto prova të administruara, rezultoi se ngastra kadastrale pronësinë për të cilën paditësi e kërkon me kërkesëpadi, në vazhdimësi ka qenë dhe është e evidentuar si pronësi në emër të paditurës – pronë shoqërore dhe më asnjë provë shkresore paditësi nuk ka mundur ta vërteton faktin se prona lëndore ndonjëherë është evidentuar si pronë në emër të personit privat apo në emër tani të ndierit siç pretendon më kërkesë padi.

Si rrjedhojë e të cekurave më lartë, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gjendja faktike nuk është vërtetuar siç duhet, si rezultat i së cilës edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht, duke qenë se paditësi e shfrytëzon pronën kontestuese se më shumë se 20 vite, ku këtë njësi kadastrale në atë kohë paditësi pretendon se e ka blerë nga T.M., kushëri i paditësit dhe një pjesë të mjeteve monetare sipas paditësit ja paguar T. M., ndërsa pjesën e mbetur djalit të T., R. M mirëpo edhe këtë pretendim paditësi ka dështuar që ta vërteton më prova para gjykatës. Paditësi pretendon se paluajtshmeria lëndore deri në vitin 1979, ka qenë e regjistruar në emër të F.M., mirëpo me matjet e aeroinqizimit, i cili është bërë në vitin 1979, e i cili ka hyrë në fuqi me datë 1984, kjo paluajtshmeri është regjistruar si pasuri Shoqërore, dhe se këtë paluajtshmeri paditësi gjithnjë e ka pasur në posedim pa asnjë bazë ligjore, pasi që e njëjta është evidentuar në emër të paditurës si pasuri Shoqërore, as këtë pretendim siç edhe u vlerësua më lart paditësi nuk e ka provuar në procedurë se paluajtshmeria lëndore para vitit 1979, ka qenë në emër të personit privat.

Me nenin 28 paragrafi 4 i LMTHPJ-së, përcaktohet se për t'u fituar e drejta e pronësisë, duhet që sendi të mbahet në posedim të pandërprerë dhe të ligjshëm (me mirëbesim), për 20 vite. Në rastin konkret, referuar provave të cekura më lartë dhe gjendjes faktike e cila rezulton nga këto prova, nga Gjykata e Apelit vlerësohet se e drejta e pronësisë nuk mund t'i njihet paditësit bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, duke qenë se është e qartë që nuk janë përmbushur kushtet për fitimin e një pronësisë lëndore.

Me nenin 28 të LMTHPJ-së, përcaktohet se mbajtësi i paluajtshmerisë për 20 vite, duhet të jetë me mirëbesim, e në rastin konkret, paditësi ka dështuar që para gjykatës të provon një gjendje të tillë që kërkohet sipas dispozitës së lartcekur. Gjykata e Apelit vlerësoni se paditësi përkundrazi asaj siç është vërtetuar nga ekspertizat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, por edhe

provat materiale tjera siç janë Librat e Regjistrave kadastrale, rezulton, se paditësi ka qenë në dijeni në vazhdimësi se ngastra lëndore, ka qenë dhe është në pronësi të paditurës.

Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit vlerëson se parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar të drejtën e pronësisë mbi një send të paluajtshëm: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. Posedimi i mbajtësit është “i ligjshëm” nëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit, ndërsa posedimi mund të jetë ligjor dhe pa pëlqim, por mund të jetë i paligjshëm, por me pëlqim. Më tutje posedimi konsiderohet se është me mirëbesim, nëse mbajtësi nuk e di ose nuk mund ta dijë se sendi nuk është i tij, ndërsa në raste të caktuara mirëbesimi supozohet. Në lidhje me elementin e tretë që ka të bëjë me kalimin e periudhës kohore të caktuar me ligj, gjykata fillon numërimin prej ditës në të cilën zotëruesi ka fituar të drejtën e posedimit të objekti (sendit), ndërsa në këtë periudhë mund të përfshihet edhe koha kur pala paraardhëse ka mbajtur sendin si zotërues i ligjshëm dhe me pëlqim, ndërsa periudhën kohore që duhet të kalojë për fitimin e të drejtës së pronësisë e parasheh ligji (LMTHJP apo LPDS). Elementi i katërt ka të bëjë me posedimin e sendit mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, por mendon se sendi është i tij dhe nuk i përket dikujt tjetër. Si rrjedhojë, referuar provave të administruar nga gjykata e shkallës së parë rezulton se në rastin e paditësit nuk përmbushen në mënyrë kumulative elementet e cekura më lartë, për të konstatuar se i njëjti e ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues mbi ngastrën kontestuese. Përveç të cekurave më lartë, sipas Gjykatës së Apelit, mirëbesimi paraqet një gjendje përmes së cilës ai në vetvete supozohet se ekziston, deri sa nuk provohet e kundërta, mirëpo meqë kemi të bëjmë me pronë shoqërore, pronë kjo specifike që gëzon një mbrojtje dhe pozitë të veçantë në të drejtën aktuale pozitive, çështja e mirëbesimit në këtë rast duhet të provohet qartazi dhe dukshëm, pa lënë vend për mëdyshje. Në mungesë të një vërtetimi të tillë të ekzistimit të mirëbesimit në shfrytëzimin e pronës së paluajtshme nga paditësi, në të cilin shfrytëzim paditësi e ka bazuar kërkesën për vërtetim të së drejtës së tij të pronësisë, Gjykata e Apelit konsideron se gjykata e shkallës së parë ka vendosur gabimisht kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa ankesën e të paditurës e vlerëson si të qëndrueshme, në tërësi.

Në anën tjetër, edhe nëse paditësi do të provonte faktin se ngastra kontestuese e ka në posedim më shumë se 20 vite, kjo nuk do të provonte automatikisht faktin se i njëjti e ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues, ashtu siç e parasheh neni 28 parag.4 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LMTHJP), i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit

juridik të pretenduar. Kjo për faktin se me nenin 29 të LMTHJP-së, parashihet se në pronë shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Edhe pse me ndryshimet e mëvonshme të LMTHJP-së të vitit 1996, neni në fjalë rezultoi të jetë i fshirë, gjykata vlerëson se bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi, respektivisht Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2000/59 për Ndryshimin e Rregullores Nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, në rastin konkret zbatohet LMTHJP, i cili ka qenë në fuqi me 22.03.1989, e jo edhe ndryshimet e mëvonshme të tij (*edhe nëse eventualisht do të zbatoheshin ndryshimet e ligjit të cekur më lartë, sërish nuk do të plotësoheshin kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues*). Në këtë drejtim, nuk qëndron arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë i dhënë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar se në praninë e të gjitha provave tjera, vetëm në bazë të shënimeve kadastrale nuk mund të konstatohet se parcela Nr. ..., . Zh, në sipërfaqe prej 6955 m², është pasuri shoqërore, pasi që nga të gjitha të dhënat tjera, veçmas nga mendimi i ekspertit është vërtetuar se ajo është pronë private dhe se gabimisht me aëroinqizim është regjistruar si pasuri shoqërore, ndërsa provat tjera siç janë ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë dhe librat e regjistrave kadastral e provojnë të kundërtën e asaj që ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit të atakuar. Si rezultat i kësaj, edhe nëse do të qëndronte një konstatim i tillë i gjykatës së shkallës së parë, atëherë bazuar në nenin 226 të Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 53/76), Ligjit për Plotësimin e Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 57/83) dhe Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 85/87, përcaktohet se: *“në qoftë se patundshmëria kalon në pronësi shoqërore pa bazë të vlefshme juridike, pronari e humb të drejtën e pronësisë, në qoftë se nuk e kërkon kthimin e pronësisë në afat prej 5 vjetësh, nga data e marrjes në dijeni, e më së largu në afat prej 10 vitesh”*. Kështu që edhe në bazë të këtyre dispozitave që kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik, rezultoi se edhe nëse do të provohej fakti se e paditura është bërë pronare e ngastrave kontestuese pa ndonjë bazë të vlefshme juridike, paditësi nuk do të mund ta fitonin të drejtën e pronësisë mbi ngastrën lëndore, për shkak të kalimit të afatit ligjor prej 10 vitesh, për të parashtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë (*pasi që është provuar fakti se e paditura është e evidentuar si pronare e këtyre ngastrave së paku që nga viti 1979, ndërsa padia nga paditësit është paraqitur në gjykatë në vitin 2010*).

Gjykata e Apelit, vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë i dhënë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar se në këtë rast gjendjen faktike e ka vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarëve Sh. S. dhe H. H., se ngastra lëndore është punuar gjithëherë nga i ish pronar faktik, paradhësit e paditësit dhe tani paditësi, dhe se nuk kanë pasur asnjëherë ndonjë problem me

askënd rreth punimit të tyre, në bazë të këtyre deklaratave gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se ngastra kadastrale kontestuese i kanë punuar dhe shfrytëzuar paraardhësit dhe vetë paditësit, pa shqetësim nga ndokush tjetër për më shumë se 20 vite, dhe të njëjtat kanë qenë të evidentuar në emër të paraardhësit të paditësve, e më pas paditësit kanë vazhduar t'i mbajnë në posedim deri më sot, ndërsa provat tjera siç është certifikatat e pronësisë e provon të kundërtën e asaj që ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, me rastin e marrjes së aktgjykimit të atakuar, për arsye se është provuar fakti se në rastin e paditësit nuk plotësohen kushtet ligjore nga neni 28.4 dhe neni 29 të LMThJP-së, për të konstatuar se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi ngastrat kontestuese të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të evidentuara si pronë shoqërore në emër të paditurës. Meqenëse nga të cekurat më lartë, ka rezultuar se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar në ligj dhe fakte, atëherë gjykata e shkallës së dytë e ndryshoi aktgjykimin e atakuar dhe refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera nga padia, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 452.2 të LPK-së, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, nga të lartcekurat, e në mbështetje të nenit 195 paragraf. 1 pika e), e lidhur me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5432/2022 datë 01.11.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,

Adnan Konushevci d.v